

DITURIA ËSHTË

Toleranca

Drejtësi

Edukata

Liri

Respekt

Mendim i
Lirë

Pushtet



Barazi

të Drejta

Sjellje-e
Mirë

Zgjellje

Sovranitet

Page

Përgjegjësi

THESAR I ÇMUAR

RËNDËSIA E DEMOKRACISË

ENDI (13), ENDRIT (12), ENIS (12), SHKURTA (12), RINIT (12), RITA (12)

Më poshtë do të mësoni për sistemin më të mirë të qeverisjes


Demokracia është sistemi më i mirë i qeverisjes, sepse populli vetë vendos për udhëheqësit e vendit të tij. Demokracia është shfaqur për herë të parë në Athinë, në vitin 507 para erës së re. Për dallim nga sot, atëherë nuk ka pasur demokraci të plotë, sepse vetëm njerëzit e pasur dhe burrat kanë pasur mundësi të votojnë. Sot të gjithë i kanë të drejtat e barabarta dhe nuk bëhet asnjë lloj dallimi.

Kosova ka demokraci përfaqësuese parlamentare, sepse deputetët i zgjedh populli dhe pastaj deputetët e zgjedhin Presidentin dhe Qeverinë e vendit.

Disa prej elementeve të demokracisë që duhet t'i zbatojmë të gjithë janë: toleranca, drejtësia, edukata, solidariteti, mendimi i lirë, paqja, barazia, sjellja e mirë, përgjegjësia, respekti, të drejtat, zgjedhjet, sovraniteti etj. Prandaj, ne duam të jetojmë në një shtet të pavarur dhe demokratik.



Gazetarët e vegjël të demokracisë




„Demos“ - popull dhe „kratos“ - pushtet



Paqe, liri dhe barazi në të gjithë botën




Populli vendos për të ardhmen e tij



Demokracia, simbol i paqes

ROLI I INSTITUCIONEVE DEMOKRATIKE

DION (12), RINESA (12), ALBIONA (12), LIBURN (12), ALTIN (12), ARBRIM (12)



Ndarja e pushtetit sipas funksioneve

Një ndër aspektet më të rëndësishme të jetës është liria, e cila është e drejta e njerëzve për të shprehur mendimin e vet. Një ndër liritë e popullit është të jeturit në demokraci.

Një formë e demokracisë është demokracia përfaqësuese. Demokracia përfaqësuese është mendimi i popullit i marrë nga një person, i cili e përfaqëson të gjithë popullin. Ky person ndryshe quhet deputet.

Sipas Kushtetutës së Kosovës, pushteti në sistemin tonë demokratik ndahet në tri degë: pushteti legjislativ, pushteti ekzekutiv dhe ai gjyqësor.

Pushtetin legjislativ e përfaqëson Kuvendi, aty ku punojnë deputetët për hartimin e ligjeve të cilat e ndihmojnë qytetarët e Kosovës. Në Kuvendin e Kosovës janë 120 deputetë, ku 20 vende janë të rezervuara për komunitetet jo shumicë. Përveç funksionit legjislativ, Kuvendi ka edhe funksion kontrollues dhe funksion

on përfaqësues. Funksioni kontrollues, prej nga e ka marrë emrin, do të thotë se Kuvendi kontrollon Qeverinë. Kurse funksioni përfaqësues e ka marrë emrin nga deputetët, të cilët bëjnë pjesë në Kuvend dhe të cilët e përfaqësojnë popullin dhe interesat e tij.

Në sistemin demokratik, pushteti i takon edhe Qeverisë që bën pjesë në degën e pushtetit ekzekutiv. Qeveria ka për detyrë zbatimin e ligjeve në funksion.

Përveç këtyre dy pushteteve, në demokraci ekziston dhe pushteti tjetër i cili është pushteti gjyqësor, i ushtruar nga gjykata. Gjykata merret me vendosjen e drejtësisë. Siç është cekur edhe në fotografinë më lart, gjykata i jep kuptim ligjeve me anë të dënimeve, nëse vërtetohet se ato ligje janë shkelur.

Ne si popull, duhet t'i respektojmë ligjet me përpikmëri që të kemi rend dhe harmoni në mes të gjithë qytetarëve. Edhe ne në grupin tonë kemi pasur role të caktuara për të pasur një rezultat sa më të mirë grupor.



Shembulli i ndarjes së roleve



Pjesa tjetër e grupit

ZGJEDHJET

ANITA (12), RIAD (12), OLTA (12), DARDANA (13), ERION (12), ARLIND (12)

Ne sot mësuam për zgjedhjet dhe llojet e zgjedhjeve në vendin tonë.

Demokracia është udhëheqje e popullit. Populli udhëheq përmes votës. Prandaj, zgjedhjet janë proces shumë i rëndësishëm, sepse ne i zgjedhim deputetët ose përfaqësuesit tonë. Ne kemi dy lloje të zgjedhjeve të cilat ndodhin në Kosovë. Ato janë: zgjedhjet lokale ose komunale, ku zgjedhet kryetari i komunës, si dhe zgjedhjet qendrore ose parlamentare, ku zgjedhen deputetët e Kuvendit. Ndërkaq, deputetët e zgjedhin presidentin e Kosovës, me anë të votave. Ne do të kemi mundësi të marrim pjesë në procesin zgjedhor kur të arrijmë moshën 18 vjeçare, sepse do të jemi më të pjekur. Vota jonë ka vlerë të madhe, prandaj ne duhet të votojmë dhe do të votojmë në të ardhmen. Ne do të jemi ndryshimi i nevojshëm për të gjithë popullin e Kosovës.



Votimi i paraqitur përmes vizatimit të gazetares Anita



Ne duhet të votojmë




Qytetarët e lumtur që kanë të drejtë të votojnë

DEMOKRACIA

Demokracia është një formë e qeverisjes që do të thotë që të gjithë qytetarët kanë të drejtë të votojnë për të zgjedhur deputetët që do të përfaqësojnë popullin.

Zgjedhjet	Votimi	Llojet e zgjedhjeve
Zgjedhjet - zgjedhjet janë shumë të rëndësishme për jetën tonë, zgjedhjet	Votimi është një gjë shumë e rëndësishme për ne sepse p.sh një deputet ka nevojë për	Llojet e zgjedhjeve janë Zgjedhjet Lokale ose Komunale që bëhen nga ana e popullit të

Ne e udhëheqim shtetin përmes votës tonë



Vota jonë ka shumë rëndësi



Gazetarët e artikullit

TË BËHEMI QYTETARË AKTIV

FLORIANI (13), BLINI (13), RIONA (12), DENISI (12), ADONIT (12), FIKNETE (12)



Të drejtat dhe përgjegjësitë që na i mundëson demokracia

Demokracia ka rol të rëndësishëm në jetën tonë. Pse? Sepse nëse ne nuk do të jetonim në demokraci, nuk do të gëzonim liritë dhe të drejta të barabarta. Demokracia ushtrohet nga shtete demokratike, e jo në shtete me qeverisje të diktaturës, p.sh. Korea Veriore. Demokracia e ka prejardhjen nga Greqia e lashtë, ndërsa Klisteni njihet si babai i demokracisë. Ne si qytetarë të një vendi demokratik, kemi të drejta dhe përgjegjësi. Të drejtat tona janë: e drejta e shkollimit, liria e shprehjes, liria e komunikimit, e drejta e votës, e drejta për të pasur një emër, e drejta e strehimit, e drejta e zgjedhjes së profesionit, e drejta e trashëgimisë kulturore, e drejta e ndarjes së pronës në mënyrë të barabartë, e drejta gjinore, etj. Ne kemi edhe përgjegjësi, dhe disa nga ato janë: të mbrojmë ambientin, të mbajmë ambientin pastër, t'iu përmbahemi rregullave në komunikacion, të respektojmë ligjin, t'iu respektojmë të moshuarit, t'iu kryejmë detyrat e shtëpisë, t'iu dëgjojmë prindërit, dhe t'iu ndihmojmë personave me aftësi të veçanta. Si mund të bëhemi qytetarë aktiv? Që të jemi qytetarë aktiv duhet të marrim pjesë në aktivitete si p.sh. në pastrimin e qytetit, apo në ruajtjen e objekteve kulturore. Prandaj, ju rini e Republikës së Kosovës ju këshillojmë që të angazhoheni, të mësoni dhe të punoni më

shumë, në mënyrë që shteti ynë të përparojë edhe më shumë, dhe që secili prej nesh t'iu gëzojmë të drejtat e liritë që na i mundëson demokracia. Ne shpresojmë dhe besojmë në vullnetin e bashkëqytetarëve tanë.



Të buzëqeshur jetojmë në demokraci



Ambienti i pastër - shëndeti i mirë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrur pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org